



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 27
Prishtinë, më 07 nëntor 2012, në orën 10:00, sala N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Albert Kinolli.

Të ftuar: z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Bajram Rexhepi- ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë; Mehmet Simnica - zyrtar i fushës për ekonomi.

Mbledhjen e kryesoi, Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.10. 2012 dhe më 17.10. 2012;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2011;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.10.2012 dhe 17.10.2012

Deputeti Murselj Haljilji, në procesverbalin e datës 17 tetor 2012, tha se ka dashur të pyes nëse Ministria ka vërejtur dhe konstatuar efektin ekonomik me rastin e realizimit të projektit: “Ngrohja e ujit me anë të energjisë solare në disa shkolla” gjegjësisht, sa është kursimi i shpenzimit të energjisë elektrike në ato shkolla. Pra, a ekziston arsyeshmëria ekonomike e këtij projekti. E dyta, nga raporti shihet se Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve e kanë dërguar në qershor. Pyetja ishte: A keni punuar konkretisht, diç, në realizimin e këtyre rekomandimeve, sidomos kur kihet parasysh fakti se nga ajo kohë kanë kaluar tre muaj?

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi njëzëri, pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.10.2012, ndërsa procesverbalin e datës 17.10.2012, me vërejtjen e deputetit Murselj Haljilji.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2011

Kryetari – Nga 10 rekomandime, janë shpalosur 4, 4 dhe janë në proces, ndërsa dy nuk janë adresuar fare. Shfrytëzimi buxhetit kapital është mbi 50%, subvencioni 32%. Ka pasur bartje nga viti në vit. Nga viti 2011, janë bartur disa shpenzime që do të prezantohen në vitin 2013. Ndërtimi i objektit, çmimi më i ulët, gjatë shqyrtimit të tenderit keni konstatuar se çmimet e dhëna nëpër pozicione të cilat i faktorizon ligji, nuk përputhen me shumën totale. Çmimi i një dere dhe një dritareje 5 euro! Për një metër kub beton, çmimi 999 euro. Kjo është e pamundur! Furnizimi me artikuj ushqimorë për të kthyerit, duhet sqaruar. Ka një ndryshim shumë të madh. Çmimi i ofruar nuk përputhet me kalkulimet nga njësitë e caktuara. Në raste të tilla, ligji favorizon çmimin për njësi. Fituesi nuk është dashur të shpallet. Kontrata është dashur të prishet. Në të kundërtën, është shkelje e ligjit. Te trajtimi i pasurisë, nuk përputhen shënimet e Ministrisë me shënimet e Thesarit. Njësia e auditimit funksionon dhe ka zbatuar planin e tyre, si dhe kanë dhënë rekomandime shumë të mira, por ato rekomandime nuk janë marrë për bazë nga menaxhmenti. Flota e automobilitave- 101 automjete janë jashtë funksioni. Keni investuar në njësi të brendshme dhe ajo njësi nuk funksionon. Pse po ndodh kjo? Po ashtu, Ministria ka edhe një shtëpi që bën kontrollin teknik, kjo duhet bërë nga vetë Ministria, e jo jashtë me një operator.

Artan Venhari, zëvendësauditor i përgjithshëm – Opinioni është i pakualifikuar, sepse për dallim nga viti paraprak, Ministria ka pasur avancime dhe ka pasqyruar saktë pasqyrat financiare. Sa i përket anës menaxheriale, të gjeturat janë të prezantuara në raport.

Ramiz Lladrovci – Përgëzoi ministrin për punën e bërë. Ka një progres të dukshëm në këtë Ministri. Nga “mohim opinionit” që kishte në vitin e kaluar, në këtë vit ka “opinion të pakualifikuar”, çka do të thotë se është opinionit më pozitiv që mund t’i jepet një organizate buxhetore. Megjithatë, prokurimi i kësaj Ministrie është jashtë funksionit. Është i pakuptueshëm çmimi prej 999 euro metër kub, i betonit. Ky është keqmenaxhim. Kontrata është dashur të anulohet. 5 euro dyer dhe dritare, transporti kushton më shtrenjtë! Ministri duhet të ndërmarrë masa lidhur me këtë, sepse për një keqmenaxhim të dikujt, të dalë një e gjetur e tillë në raporte të Ministrisë, është e patolerueshme.

Pastaj, kontratat e ushqimit, kontrata për furnizim me inventar të zyrës në Policinë e Kosovës, janë të gjetura serioze. Raporti ka një opinion shumë të mirë, por kërkoj që të ndërmerren masa ndaj atyre që kanë bërë keqmenaxhim.

Valbona Dibra- Opinioni për këtë Ministri është “opinion i pakualifikuar” çka do të thotë se pasqyrat financiare të kësaj Ministrie janë pasqyruar drejt. Ka një progres të madh dhe Komisioni po arrin rezultat, sepse vitin e kaluar gjendja ka qenë krejt tjetër. Madje

personalisht, ka kërkuar trajnimin e stafit të kësaj Ministrie. Pra, ka një angazhim të dyfishtë nga Komisioni dhe Ministria, për përmirësimin e gjendjes dhe rezultatet janë pozitive.

Sa i përket të hyrave, është një pasqyrë e mirë. Të hyrat janë të harmonizuara në mes të departamenteve dhe kjo bën që Ministria të krenohet me këtë. Uroj që stafi të avancohet nga dita në ditë dhe rekomandimet e ZAP-it të realizohen me përpikëri.

Prokurimi përbën sfidë për të gjitha institucionet dhe nuk mund të arsyetohen të gjeturat të cilat kërkojnë hetim të mëtutjeshëm.

Mursel Hajllilji- Tha se ka avancime në këtë Ministri, por kam një pyetje për auditorin. Lidhur me të gjeturën që ngriti deputeti Ramiz Lladrovci, për arritjen e marrëveshjes me OE të papërgjegjshëm- furnizim me inventar për zyrë, dua t'i referohem pasuesit sipas të cilit OE ka ankuar në OSHP, që ka konfirmuar vendimin e Ministrisë, si vlerësim në pajtim me ligjin. Pyetje për ZAP-in se si ka ardhur deri te kjo e gjetur, sepse OSHP është autoritet i cili vlerëson nëse vendimi i organit kontraktues është i drejtë ose jo. E njëjta është çështja edhe në f. 16 të raportit, ku përsëri OSHP ka vërtetuar vendimin e Ministrisë.

Pyetje për Ministrinë, f. 19- investimet të cilat nuk janë futur në përdorim. A keni ndonjë plan që kjo të realizohet, sepse do të ishte mirë që këto investime të vihen deri në fund.

Buxheti është shpenzuar 85%. Propozoi që të investohet në dogana, të blihen mjete bashkëkohore për mbrojtjen e kufijve, sepse kjo do të na ndihmonte të gjithëve.

Armend Zemaj – Tha se kemi të bëjmë me një sektor të veçantë. Pavarësisht opinionit, sipas të cilit pasqyrat kanë arritur të pasqyrohen saktë, kontrolli i brendshëm ka nevojë të forcohet, sidomos në prokurim. Problematikat kryesore që kanë të bëjnë me tenderë të ndryshëm, ka të bëjë me kompanitë e njëjta dhe kjo çështje duhet trajtuar edhe me OSHP-në. Këto kompani ose kanë pasur specifikacion të dyshuar, ose jo saktësi në përmbushjen e obligimeve.

Shihet që në Ministri ka mungesë profesionalizmi. Ministri duhet të ndërmarrë masa konkrete dhe mbi bazën e rezultateve, të ndërmerren masa. Këta njerëz, pavarësisht këtyre të gjeturave, kanë vlerësim pozitiv dhe kjo lë vend për të dyshuar se mund të involvohet edhe menaxhmenti i lartë.

Albert Kinolli – Avancimet në këtë Ministri janë evidente. Kam pyetje që ka të bëjë me vazhdimin e kontratës për furnizim me telefoni mobile. Sipas raportit, nënshkrimi i kontratës është bërë duke anashkaluar kërkesat ligjore.

Numri i të punësuarve në Departamentin për Emigracion, Shtetësi dhe Azil, me buxhet është paraparë 22 punëtorë, dhe sipas auditorit, 11 janë punësuar si tepriçë. Domethënë, ka 33 të punësuar dhe 4 raste të ndërprerjes së kontratës në Policinë e Kosovës dhe nuk korrespondon me ndalesën e pagës.

Bajram Rexhepi, ministër - Garantoj se kemi bërë të gjitha përpjekjet që të arrijmë të orientohemi në adresimin e rekomandimeve të ZAP-it. Kjo argumentohet me opinionin e auditimit për vitin 2011, si i pakualifikuar.

Çështjet që janë ngritur edhe në Raportin e auditimit, janë të sakta, mirëpo arsyet pse kanë ndodhur, mund të jenë karakterit edhe subjektiv. Siç e dini, MPB-ja ka një numër të konsideruar të agjencive dhe departamenteve gjegjëse.

Në disa raste, ne duhet të kërkojmë specifikacione të veçanta teknike, për shkak të natyrës specifike të projekteve, mirëpo lëshimet teknike mund të ndodhin.

Në disa raste, ne i kemi duart e lidhura sa i përket rregullave strikte të Ligjit të prokurimit, bie fjala tek Departamenti i Azilit, ne kemi qenë të detyruar që për personat që kanë kërkuar azil, të paguajmë edhe hotele për akomodim, për shkak të mungesave të objekteve për vendosje.

Në MPB, ka drejtor të prokurimit, mirëpo në polici ende nuk ka drejtor të prokurimit, për shkak se ish- drejtori i prokurimit është i suspenduar dhe po përballet me procedurë gjyqësore, kështu që neve si Ministri, po na paraqet problem dhe nuk po mund të shpallim konkurs për këtë pozitë.

Në pyetjen e deputetit Kinolli, sa i përket shpenzimeve për telefoninë mobile, është e vërtetë se

ne kemi pasur një kontratë me operatorët ekonomikë për shërbimet e telefonisë mobile dhe kjo kontratë ka qenë shumë e favorshme, ku të gjithë pjesëtarët e SHPK-së kanë qenë në një rjet. Kjo në një formë e ka lehtësuar shumë punën e komunikimit në mes zyrtarëve të policisë. Fillimisht, është bërë me një marrëveshje të mirëkuptimit me operatorin ekonomik publik, ndërsa më vonë kemi shkuar sipas prokurimit me shpallje publike të tenderit.

Ne kemi pasur një bord të pavarur mbikëqyrës ndërqeveritar, ndërsa nga kjo ka dalë çështja e të punësuarve dhe tejkallimit të numrit të punëtorëve në nivel të Departamentit të Azilit. Është e vërtetë se ka pasur tejkallim, mirëpo kjo ka ndodhur në fazën fillestare ku ishin të punësuar 32 persona dhe se tani kjo çështje është e rregulluar deri në numrin 22, pra në numrin sa ishte i lejuar me buxhet.

Të një rëndësie të veçantë e kemi edhe flotën e veturave të policisë. Është shumë e vërtetë se këtu kemi shpenzime të mëdha. Arsye për këtë është se këto vetura gjithnjë janë në lëvizje dhe se shpenzimet dhe norma e amortizimit të tyre është e lartë, po ashtu edhe mirëmbajtja e tyre. Garazhi për servisimin e tyre fillimisht është bërë në bashkëpunim me një kompani slovene për mirëmbajtje, ndërsa punëtorët kanë qenë të policisë dhe se qëllimi i saj ka qenë që këta të punësuar të aftësohen. Në ndërkohë, pas skadimit të kësaj kontrate, ne kemi bërë kontrata me operatorët ekonomikë për servisimin e veturave, po ashtu duke përfshirë edhe kontrollimin teknik të tyre, që është e vërtetë se kushton shumë. Problem në vete në këtë është edhe servisimi shumë i ngadalshëm i tyre.

Si ministër i MPB-së, nuk jam ithtar që flotën e policisë ta mbajmë me servisim nga SHPK-ja. Duhet të gjenden modalitetet përmes partneritetit publiko-privat, apo forma të tjera të mbajtjes së flotës. Po ashtu, edhe Inspektorati Policor është duke bërë hetime se mos ka keqpërdorime në këtë fushë.

Jemi të kënaqur me punën e Auditorit të Brendshëm të MPB-së, si dhe kemi një bashkëpunim shumë të mirë edhe me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

Ramiz Lladrovci – Ofertuesi është dashur të eliminohet automatikisht në rastin kur çmimi i ofruar nga OE, nuk korrespondon me çmimin real. 5 euro dritare është e papranueshme, ndërsa në këtë rast, komisioni vlerësues nuk e ka bërë punën mirë. Pastaj, në rastin e furnizimit me pajisje për zyrë, nëse ne specifikacion ka qenë kërkesë katalogu, atëherë atë specifikacion është dashur ta respektojë komisioni vlerësues, e jo çështja të shkojë në OSHP.

Armend Zemaj – Komisioni dëgjoi fjalën e ministrit dhe nuk ka nevojë që zyrtari i prokurimit të marrë fjalën para Komisionit. Ata janë përgjegjës para ministrit.

Agim Fejzullahu, Zyra e Prokurimit në MPB – Pyeti: A u është bërë një vlerësim juridik të gjeturave nga ana e Komisionit, apo vetëm një vlerësim material dhe politik? Ligji për prokurim publik është nxjerrë nga Kuvendi. Mbi çfarë baze të eliminojmë këtë OE, kur çmimi total është projekti që është ndërtuar jo çmimi në tërësi.

Baza juridike e korrigjimit të ofertës ka qenë që, me një udhëzim të veçantë, është lejuar ndryshimi aritmetik, jo korrigjimi material. Vetëm totali ka qenë gabim ekonomik, jo të tjerat.

Ramiz Lladrovci- Me ligj, korrigjimi aritmetik lejohet deri në një shumë të caktuar, jo deri në 64%.

Valbon Bytyçi, ZAP - Lidhur me parregullsitë e kontratës për furnizim me pije, sipas nenit 8 të Udhëzimit Administrativ, thuhet se çdo korrigjim që çon në dëmtime të mëdha materiale, do të konsiderohet tender jovalid. Korrigjimi në vlerën 64% është material dhe kjo është e një rëndësie të madhe, jo e një rëndësie të ulët, siç quhet këtu.

Arritja e marrëveshjes me operatorin e papërgjegjshëm, sepse operatori fitues nuk i ka sjellë të gjithë katalogët. Prandaj, në bazë të kriterëve edhe ky operator ishte i papërgjegjshëm. Kompania e dytë, e cila ishte më e lirë për mbi 40 mijë euro, për të njëjtin kriter, operatori i parë është cilësuar i përgjegjshëm, i dyti është cilësuar i papërgjegjshëm. OSHP, ka vlerësuar se vlerësimi është bërë në pajtim të plotë me Ligjin, por ZAP –i ka fakte se kjo nuk qëndron.

Përshtatja e specifikacionit teknik për operatorin e caktuar ekonomik, në bazë të ligjit, neni 28 thotë se autoriteti e ka të ndaluar të hartojë specifikimet teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një apo më shumë OE dhe i referohet një artikulli etj... Te kontrata furnizim me autobllinda i kemi cekur dy pozicione, madhësia e motorit, madhësia fikse, kjo nuk lejohet, lejohet minimumi, por jo madhësia fikse. Ky specifikacion ka favorizuar një operator ekonomik. Lidhur me këtë, OSHP ka vlerësuar se vendimi i Ministrisë ka qenë në rregull.

Ramiz Lladrovci- Pyeti auditorin nëse është e mundur që të bëhet auditimi i agjencive që bien në kompetencë të MPB-së, që ato të auditohen ndaras, sepse ministri nuk ka përgjegjësi për këto agjenci.

Bajram Rexhepi, ministër – Lidhur me çështjen e autobllindave tha se janë pajisje të veçanta që nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit.

Valbon Bytyçi – MPB-ja ka procedura specifike. Në këtë rast shkohet me procedura të negociuara, por në këtë rast kanë shkuar me procedurë të hapur dhe këtu është bërë gabimi.

Kryetari Konstatoi se, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Të kërkohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej një muaj (1 muaj), t'i paraqesë Raport me shkrim Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra nga kjo Ministri, për të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.
2. Raporti, veçanërisht duhet të përmbajë të dhëna për lëndët:
 - furnizim me ushqim për Ministrinë e Punëve të Brendshme,
 - sqarim lidhur me kontratën me Operatorin Ekonomik "ALBES" për ndërtimin e objektit për Agjencinë për Regjistrim Civil në Prishtinë, si dhe,
 - sqarim lidhur me kontratën për furnizim me inventar për zyrë, për Policinë e Kosovës.
3. Lidhur me propozimin e deputetit Armend Zemaj, për t'ju drejtuar OSHP-së, lidhur me operatorët ekonomik-joserioz, Komisioni do ta diskutojë këtë çështje në takimin e datës 13 nëntor 2012, me auditorin e përgjithshëm.

4. Të ndryshme

a) Mbledhja e radhës e Komisionit

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se Mbledhja e radhës është planifikuar, më 14 nëntor 2012, në orën 10:00.

Po ashtu, kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se, meqenëse mbledhjet e Komisionit janë të mërkurave, çdoherë kur caktohet mbledhja e Komisionit, një ditë para mbledhjes mbahet takimi i kryetarit dhe dy zëvendësve, me auditorin e përgjithshëm. Ftohen edhe anëtarët tjerë të Komisionit, të cilët shprehin interesim të marrin pjesë në këto takime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu

